

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Fijona Stuja–praktikante pranë kësaj Gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. G. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.1681/2017, të datës 20.02.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datë 20.11.2018**, në prezencën e Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datën 21.11.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S. G., nga i ati F., e ëma N., e gjinisë M., data e lindjes... në Mitrovicë, tani me banim në Gjakovë në rrugën “...” numër, i martuar, baba i 3 (tre) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë të pavërtetuar e deri me datën 12.06.2017, në shtëpinë e tij ë Gjakovë, në rrugën “...”, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që njehsorin elektrik me numër ka hequr pllombat distributive përmes kabllos linja L2 e ka lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar , gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë me rastin e kontrollës, me ç’rast të dëmtuarës K. Divizioni i Rrjetit- Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në shumë të përgjithshme prej 124.48 Euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 58, 73, 74 dhe nenit 320 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME KUSHT duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, dhe

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 160 (njëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 1 (një) muaji, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Detyrohet i akuzuari S. F. G. nga Gjakova, që të dëmtuarës K. Distrikti në Gjakovë, t'ia kompensoi në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 124.48 Euro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1681/2017, të datës 20.02.2018, ndaj të akuzuarit S. G. nga Gjakova, për shkak veprës penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj gjatë shqyrtimit fillestar ka bërë përmirësimin e përshkrimit faktik të aktakuzës duke theksuar se ë në rreshtin e parë ku është shënuar “në lokalit të tij” duhet të jetë “në shtëpinë e tij” dhe po ashtu ka bërë kualifikimin juridik ashtu që duhet të hiqet fjala “në vazhdimësi” ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshua. Prokurorja e shtetit, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit S. G. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari S. G., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe ka shtuar se është penduar për këtë veprim dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari S. G., me datë të pavërtetuar e deri me datën 12.06.2017, në shtëpinë e tij ë Gjakovë, në rrugën “...”, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që njehsorin elektrik me numër ka hequr pllombat distributive përmes kabllor linja L2 e ka lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim ka shfrytëzuar energjinë elektrike duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë me rastin e kontrollës, me ç'rast të dëmtuarës K. Divizioni i Rrjetit- Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në shumë të përgjithshme prej 124.48 Euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurorja e shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale veprës penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe

lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se: është baba i 3 (tre) fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes prej 5 antarësh, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Ndërsa duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëj rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në bazë të nenit 463 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që i akuzuari S. F. G. nga Gjakova, t'ia kompensoi të dëmtuarës K-Distrikti në Gjakovë në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 124.48 Euro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.176/18, me datë 20.11.2018

Procesmbajtësja,
Fijona Stuja

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.